



**INFORMACION
PËR GJYQTARËT
PRANË SEKSIONEVE
FAMILJARE**

**PJESËMARRJA E PSIKOLOGUT
NË PROCESIN GJYQËSOR
ME TË MITUR**



unicef 
for every child

I. Kur thirret psikologu për të ndihmuar të miturin në çështjet familjare?

Kuadri ligjor

- Prania e detyrueshme e psikologut, në çdo procedurë që i përket të miturit, për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën e tij sociale, është një ndër parimet themelore të shpallura nga Kodi i Familjes (neni 6, paragrafi i fundit).
- Veç kësaj, Kodi i Familjes e përforcon praninë e detyrueshme të psikologut edhe në dispozita të tjera që kanë të bëjnë me procese specifike që iu përkasin të miturve. Kështu, neni 273, paragrafi i fundit, parashikon që i mituri të dëgjohet, në praninë e psikologut në gjykimin që ka të bëjë me kthimin e fëmijës pranë kujdestarit të vet.
- Pjesëmarrja e psikologut përmendet edhe në nenet 155, 157 dhe 267, që kanë të bëjnë me lënien e fëmijës për rritje dhe edukim, të drejtën e vizitës, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe kujdestarinë.

Roli i psikologut si ndihmës i të miturit në çështjet gjyqësore familjare

Kur thërrisni në një proces psikologun ndihmës kini parasysh që ai:

- Ofron mbështetje emocionale për të miturin e përfshirë në proces, duke lehtësuar dhënien e mendimit apo dëshmisë së tij në gjykatë. Mbështetja e fëmijës është e domosdoshme në mënyrë që ai të ndjehet i sigurtë, i inkurajuar dhe i kuptuar;
- Lehtëson komunikimin midis gjykatës dhe fëmijës;
- Thirret paraprakisht për të konsultuar pyetjet me gjyqtarin për t'i përshtatur ato në mënyrë që të mos ndikojnë negativisht në gjendjen emocionale të të miturit.

Për një proces intervistimi në interesin më të lartë të fëmijës, është e rekomandueshme që ju të:

- Mundësoni kohën e nevojshme përgatitore për vendosjen e komunikimit midis psikologut dhe fëmijës vetëm për vetëm në një ambient të përshtatshëm, para zhvillimit të seancës gjyqësore.
- Shmangni prezencën e çdo pale, përfshirë mbrojtësit ligjorë kur pyesni fëmijët lidhur me çështjet familjare. Në të kundërt, do të rrezikoni të merrni



një informacion të pasaktë dhe një proces i tillë do të ndikonte negativisht në gjendjen emocionale të fëmijës.

- Të filloni bisedën me pyetje të hapura mbi çështje neutrale që lidhen kryesisht me përditshmërinë e të miturit. Më pas, ju mund të kaloni në pyetje të cilat lidhen me çështjen në fjalë.
- Konsultohuni me psikologun në mënyrë që të tregohet kujdes për të respektuar refuzimin apo paaftësinë e fëmijës për t'iu përgjigjur pyetjeve apo çështjeve të caktuara.
- Ju dhe psikologu të keni në vëmendje faktin se nëse fëmija jep përgjigje jo konsistente, në mënyrë të veçantë mbi ndjenjat apo perceptimet e tij mbi situatën familjare, kjo mund të jetë tregues i një konfuzioni që fëmija është duke përjetuar. Ky duhet parë si një reagim normal i shumë fëmijëve kur përballen me situata stresuese, siç janë proceset gjyqësore.
- Në çështjet familjare, kur nga gjykata kërkohet si provë një vlerësim psikologjik, por në të njëjtën kohë gjykata kërkon të marrë mendimin e të miturit në seancë gjyqësore, rolin e psikologut ndihmës e merr eksperti vlerësues, i cili ka përgatitur vlerësimin psikologjik. Në këtë rast psikologu vlerësues ka ndërtuar gjatë vlerësimit një marrëdhënie besimi me të miturin, faktor i cili është lehtësues në rolin e tij si ndihmës si dhe i jep fëmijës siguri e komoditet emocional gjatë dhënies së mendimit të tij/saj.

II. Roli i psikologut si ekspert vlerësues në çështjet gjyqësore familjare

Kuadri Ligjor:

- Neni 155, parashikon thirrjen e psikologut/punonjësit social nga gjykata për të dhënë mendimin e tij, lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarin e fëmijës njërit ish-bashkëshort, qoftë në mënyrë të përkohshme, qoftë në mënyrë të përhershme;
- Neni 157, germa c, parashikon se gjykata, para se të vendosë për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ose për t'ia besuar fëmijën një të treti, në rast abuzimi të përgjegjësisë prindërore, merr në konsideratë mendimin e psikologut;

- Neni 267, paragrafi i fundit, parashikon marrjen e mendimit të psikologut nga gjykata, për caktimin e kujdestarit. Po ashtu, ky nen dikton praninë e të njëjtit psikolog përgjatë këtij gjykimi;
- Ligji nr.9695/2007, i ndryshuar, «Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit», në nenin 22, paragrafi 2, germa b, parashikon si pjesë të dokumentacionit të fëmijës që do të birësohet edhe raportin për gjendjen psikologjike, fizike dhe sociale të tij;
- Ligji 18/2017, neni 29 «Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës» parashikon gjithashtu detyrimin e institucioneve që të garantojnë në çdo proces gjyqësor ndihmën psikologjike falas për fëmijën, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e tij. Kjo dispozitë kërkon që ndihma psikologjike t'i ofrohet fëmijës drejtpërdrejt dhe pa pengesa, bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe të interesit më të lartë të fëmijës. Ndhma psikologjike përfshin të gjitha veprimet, si dhe këshillimet që kryen psikologu i caktuar nga gjykata (apo autoritetet e tjera përgjegjëse)

Atributet e psikologut që kryen vlerësime në çështjet familjare¹:

1. Të njohë kontekstin ligjor të vendit ku zhvillon punën e tij;
2. Të ketë njohuri në kërkim, teori, politika dhe praktikë lidhur me zgjidhjen e martesës dhe çështjet e lënies për rritje dhe edukim të fëmijës;
3. Të ketë njohuri në: Vlerësimin psikologjik të të rriturve dhe fëmijës, Psikologji zhvillimi, Psikologji e familjes, Psikopatologji e të rriturve dhe fëmijëve;
4. Të njohë Efektet e zgjidhjes së martesës dhe grafikun e prindërimit për të rritur dhe fëmijë;
5. Të njohë Kodin Etik të Psikologut.


Sa më sipër mund ta ndihmojnë gjykatën të bëjë përzgjedhjen më të përshtatshme nga lista e përgjithshme, e vënë në dispozicion nga Urdhri i Psikologut.

Çështjet familjare në të cilat kërkohet vlerësimi psikologjik

Psikologu vlerësues jep ekspertizën e tij në çështjet familjare ku është i përfshirë i mituri:

- Zgjidhje martese; Lejtim martese; Caktimi i përgjegjësishë prindërore; Caktim kujdestari; Heqjen e përgjegjësishë prindërore; Lëshim autorizimi

1 Condie 2003, Guidelines for child custody evaluations in Child Matters



për lëvizjet e fëmijës jashtë shtetit me prindin tjetër; Lëshim i urdhrit të mbrojtjes; Birësim, etj.

Standarde dhe parime në realizimin e vlerësimit psikologjik

- Roli kryesor i psikologut vlerësues është t'iu japë përgjigje pyetjeve referuese të drejtuara nga gjykata dhe t'iu përmbahet këtyre pyetjeve gjatë gjithë vlerësimit.
- Qëllimet e vlerësimit bazohen te pyetjet referuese që ngrihen që në fillim të procesit. Pyetjet referuese të drejtuara nga gjykata duhet të jenë specifike, me natyrë psikologjike, të matshme dhe brenda kompetencës profesionale të psikologut vlerësues.
- Raporti i vlerësimit psikologjik duhet të përmbledhë procesin e vlerësimit duke bërë transparente cilat janë pyetjet e gjykatës, cila është procedura e ndjekur, çfarë të dhënash janë mbledhur dhe si ndikojnë ato te konkluzionet e marra nga vlerësuesi. Raporti i vlerësimit psikologjik duhet t'i sigurojë gjyqtarit informacionin e nevojshëm që i duhet atij për të marrë një vendim të informuar.
- Metodatat e vlerësimit në çështje familjare përfshijnë: intervista individuale me të rritur dhe fëmijë, vëzhgime, testim, mbledhje informacioni nga dokumentacioni dhe burime të treta informacioni, shkrim raporti dhe ndarje informacioni.
- Kur pavarësisht përpjekjeve, një ekzaminim i tillë nuk është praktik dhe nuk i shërben si duhet gjykimit, psikologu dokumenton përpjekjet e tij, rezultatin e këtyre përpjekjeve dhe bën të qartë impaktin e mundshëm të kufizimit që sjell ky informacion i paplotë në besueshmërinë dhe vlefshmërinë e opinionëve të tij.
- Vlerësimi psikologjik është një proces me tre faza: 1) Marrja e të dhënave; 2) Interpretimi i të dhënave; 3) Përdorimi i të dhënave. Një mesatare e raportit të vlerësimit psikologjik mund të jetë 10-25 faqe.
- Raporti psikologjik duhet të mbulojë fusha të tilla bazike vlerësimi, si: Marrëdhënia midis dy prindërve, Marrëdhënia prind/fëmijë, Aftësitë prindërore të secilit prind, Shëndeti psikologjik i secilit anëtar, Dinamikat familjare.
- Metodatat e përdorura në vlerësim duhet të mbështeten nga studimet dhe kërkimet shkencore rreth aplikimit të tyre në këto lloje vlerësimesh.

- Është e rekomandueshme që të shkruhet edhe referenca përkatëse. Kjo i lejon ekspertët ligjorë, por edhe palët të shikojnë se mbi cilat burime dhe studime është mbështetur vlerësuesi.

Tarifa e ekspertit

Në rastet kur shërbimi ka një tarifë për ekspertin, psikologu diskuton me prindin e fëmijës dhe avokatin e tyre lidhur me tarifat. Këto tarifa:

- a)** duhet të jenë në përputhje me ligjin;
- b)** të mos jenë abuzive dhe të mos paraqiten në faturë ndryshe nga sa janë bërë në realitet;
- c)** nëse kufizimet e shërbimit mund të paraprihen për shkak të kufizimeve financiare, kjo diskutohet sa më parë me marrësin e shërbimit.

Disa nga çështjet kryesore për të matur përputhshmërinë prindërore dhe interesin më të lartë të fëmijës janë si më poshtë:^{2 3}

- Cilat janë aftësitë e secilit prind për të prindëruar në mënyrë efektive?
- Cilat detyra prindërore ka kryer secili prind në të kaluarën?
- Cila është marrëdhënia e secilit prind me fëmijën?
- Sa janë të aftë prindërit të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin?
- A ka ndonjëri nga prindërit probleme fizike apo psikologjike të cilat ndikojnë negativisht në lidhje me aftësitë prindërore?
- Cila është aftësia përballuese dhe personaliteti i fëmijës?
- A ka tregues të dhunës në familje apo të abuzimit me fëmijët?
- Cilat janë dëshirat e secilit prind dhe fëmijë në lidhje me zgjidhjen e martesës?

Seksionet e Raportit të Vlerësimit Psikologjik në çështjet familjare:

Pavarësisht formateve që psikologë të ndryshëm përdorin, seksionet kryesore të një raporti duhet të përfshijnë:

- 1.** Titulli i raportit;
- 2.** Përmbajta e raportit (sipas modelit të nën-ndarjeve që renditen më poshtë):

2 A comprehensive guide to child custody evaluations, mental health and legal perspective Rohrbaugh, Joanna Bunker, fq. 169-196

3 Child custody evaluations, P.M. Stahl, fq. 23-42



- a)** Informacioni i sfondit për familjen⁴ (historiku i marrëdhënies bashkëshortore);
 - b)** Arsyet e kryerjes së vlerësimit dhe çështjet që duhet të adresohen nga vlerësimi;
 - c)** Metodologjia: Duhet të shpjegohet se cila është arsyeja që një teknikë e caktuar është apo nuk është përdorur në vlerësim;
 - d)** Vlerësimi i secilit prind ku përfshihen: Shqetësimet dhe dëshirat, Historia familjare, marrëdhënia bashkëshortore, Shkollimi dhe karriera,⁵ Shëndeti, Kushtet e të jetuarit, Historia e marrëdhënies me fëmijët dhe të dhëna për këtë marrëdhënie, Funksimimi psikologjik dhe social, Përmbledhje për secilin prind;
 - e)** Fëmijët: Ky seksion përmbledh përshtatjen emocionale, sociale dhe kognitive të fëmijës me mjedisin ku jeton: prindërit, shkollën dhe marrëdhëniet në komunitet;
 - f)** Dinamikat familjare;
 - g)** Çështje specifike (abuzimi seksual, dhuna në familje, qoftë ndaj fëmijës, qoftë ndaj anëtarëve të tjerë të familjes, etj.) për të cilat Gjykata mund të mos ketë drejtuar pyetje specifike, por që kanë rezultuar gjatë vlerësimit. Ndërkaq, në vlerësimet për urdhrat e mbrojtjes, këto çështje janë në fokusin kryesor të vlerësimit.
- 3.** Përmbledhje dhe konkluzione të përgjithshme. Ky seksion mund të orientohet në bazë të pyetjeve të dhëna nga gjyqtari, të përkthyer në variabla psikologjore;
- 4.** Rekomandime: psikologu iu jep përgjigje pyetjeve, por gjithashtu i rekomandon gjykatës planin më të përshtatshëm të prindërimit.

4 Child custody evaluations, P.M. Stahl, fq.75-97

5 A comprehensive guide to child custody evaluations, mental health and legal perspective, fq. 323-347

KUJDES!

- Kur ju duhet të intervistoni një të mitur, apo kur duhet të thërrisni një psikolog ekspert për të kryer vlerësim në çështjet familjare, ju duhet të zgjidhni një psikolog të specializuar në kryerjen e vlerësimeve të kësaj natyre.
- Lista e psikologëve që mund të thirren në rolin e asistuesve, si dhe të vlerësuesve në proceset e së drejtës familjare i është dërguar zyrtarisht institucionit tuaj nga Urdhri i Psikologut të Republikës së Shqipërisë. Psikologët e trajnuar janë pajisur me çertifikatë dhe kartë identifikimi të posaçme. Nëse në qarkun/rrethin tuaj nuk ka psikologë të trajnuar nga lista e ofruar nga Urdhri, atëherë në këtë funksion mund thërrisni një psikolog nga qarku/rrethi më i afërt. Një psikolog i cili nuk është trajnuar në kryerjen e vlerësimeve në fushën e së drejtës familjare, nuk mund të caktohet në këtë funksion, pasi procedimi mund të kundërshtohet nga palët për pavlefshmëri.



Për të kontaktuar me Urdhrin e Psikologut:

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Ndërtesa 26,
Kati 2, Ap.9, Tiranë (pranë E88)

Email: info@urdhriipsikologut.al

sekretaria@urdhriipsikologut.al

presidenti@urdhriipsikologut.al

Web: www.urdhriipsikologut.al